REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 452 Prot. Tiranë, më datë 21.09.2026

VENDIM
Nr. 286, datë 21.09.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", i ndryshuar, neni 38, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "*Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.09.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e projektit *"Restaurim dhe konsolidim i pjesshëm i Murit Antik në anën veriore të qytetit mesjetar të Lissus-it, Lezhë"*, shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë me emërtimin "*KALAJA E LESHIT, (LISSOS) përmbi qytetin e Leshit, në kuotën 172, duke përfshirë muret e kalasë mesjetare si edhe gërmadhat e mureve të ndërtuara me gur të mëdhenj, e kufizuar nga veriu me rrugën që të shpie në Varosh, nga Lindja me qafën, nga Perëndimi e Jugu me shtëpitë e para të qytetit. 2.MURET E QYTETIT ANTIK LIS*", me aplikues dhe zhvillues **DRTK Shkodër;**
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, i ndryshuar, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

KRYETAR
Blendi GONXHJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE - SEKRETARIATI TEKNIK - MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT - TIRANË

Endri Haxhiu
Digitally signed by Endri Haxhiu
Date: 2026.09.29 13:42:19 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
3e156d148d40429782f65d0400b391992026092913421
800040

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara", Kinostudio, Tiranë, Shqipëri,
Email: info@iktk.gov.al; www.iktk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)